

THIRRJE PËR APLIKIM

Trajnim:

Raportimi mbi standardet e sundimit të ligjit

Në kuadër të projektit rajonal "Përmirësimi i raportimit për sundim të ligjit në Kosovë", Grupi për Ballkan do të zhvillojë një trajnim dy ditor mbi procedurën penale dhe përgjegjësinë ligjore dhe etike të gazetarëve.

Qëllimi i këtij trajnimi është që të fuqizojë studentët e gazetarisë si dhe gazetarët e rinj të cilët raportojnë në fushën e drejtësisë duke përmirësuar nivelin e njohurive të tyre lidhur me procedurat ligjore dhe komunikimin me gjykatat, prokurorët dhe avokatët.

Ky trajnim do të jetë i ndarë në dy pjesë, ku në ditën e parë do të ligjërohet për procedurat penale, e cila do të përfshijë temat si:

- Fazat procedurale,
- Dënimet (rrethanat rënduese dhe lehtësuese),
- Marrëveshja e shtyer e prokurorisë dhe marrëveshja për pranimin e fajësisë,
- Përfundimi i aktgjykimeve, gjykatave të shkallës së ndryshme dhe mjeteve juridike.

Ndërkaq në ditën e dytë, do të ligjërohet mbi përgjegjësinë ligjore dhe etike të gazetarëve. Kjo pjesë do të përfshijë tema si:

- Komunikimi me pjesëmarrësit në procedurën penale,
- Përgjegjësia ligjore dhe etike e gazetarit.

Aplikantët e përzgjedhur do të njoftohen për detaje të tjera të trajnimit pasi që të jenë informuar për pranimin në trajnim.

Trajnimi do të mbahet me datë **2 dhe 3 tetor 2018**, ndërkaq afati i fundit për aplikim është **24 shtator 2018**.

Të gjithë të interesuarit mund të dërgojnë një CV dhe letër motivuese në email adresën vsadriu@balkansgroup.org.